



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

KARPENTIERI, HEKURKTHIM

DHE BETONIM

Niveli III në KSHK¹ referuar nivelit III të KEK²

B3-III-22

Tiranë 2022

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site: www.akafp.gov.al

Tel/fax.+355 42237087

Emërtimi i kualifikimit	Karpentieri, hekurkthim dhe betonim			
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	Kodi B3-III-22
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Karpentieri, hekurkthim dhe betonim”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, të drejtimit mësimor “Ndërtim”, është “zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me karpentierinë, hekurkthimin dhe betonimin”.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Karpentieri, hekurkthim dhe betonim” niveli III në KSHK-së, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Ndërtim”, niveli II në KSHK-së, referuar nivelit II të KEK; – janë në kushte shëndetësore që e lejojnë përballimin e kërkesave të këtij niveli të kualifikimit profesional. <p>Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucionet përgjegjëse përgatisin udhëzime të veçanta me kriteret të posaçme pranimit për këto shkolla.</p>			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin mësimor “Karpentieri, hekurkthim dhe betonim”, niveli III në KSHK-së, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të nivelit, të punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në sipërmarrje ndërtimi shtetërore/private si karpentier, hekurkthyes, betonues, si dhe mund të punësohet në njësi të shitjes së materialeve të ndërtimit. Mbas një përvoje pune, ai/ajo mund të vetëpunësohet si sipërmarrës duke punësuar individë të tjerë në veprimtari të punimeve të karpentierisë, hekurkthimit dhe betonimit.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, (teknik/menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	B-II-03-11, B-II-03-18			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin mësimor “Karpentieri, hekurkthim dhe betonim” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Planifikimi dhe organizimi i punës

- Të përshkruajë legjislacionin kryesor për punimet e ndërtimit;
- Të shpjegojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;
- Të interpretojë një projekt të dhënë;
- Të përshkruajë mënyrën e organizimit të vendit të punës sipas procesit përkatës në mënyrë ergonomike;
- Të shpjegojë rëndësinë e koordinimit të punës me disiplinat e tjera për organizimin e punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e hartimit dhe zbatimit të grafikut të punimeve;
- Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të materialeve sipas procesit të punës;
- Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të mjeteve dhe pajisjeve sipas procesit të punës;
- Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të burimeve njerëzore sipas procesit të punës;
- Të përshkruajë mënyrën e përzgjedhjes së mjeteve dhe veglave të punës sipas proceseve;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së preventivit për proceset e punës;
- Të përshkruajë mënyrën e mirëmbajtjes së mjeteve dhe veglave të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së higjienës personale në punë;
- Të përshkruajë mënyrën e sistemit të materialeve, mjeteve të punës, instrumenteve matëse-niveluese dhe makinerive në vendin e punës;

Konstruksione mbajtëse

- Të rendisë llojet e konstruksioneve mbajtëse të ndërtesës;
- Të përshkruajë elementët konstruktive përbërëse të konstruksioneve prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë vizatime konstruktive të projekt-zbatimit për elemente të ndryshme prej betoni të armuar (shtylla, trarë, pllakë ndërkatë dhe rampë shkallësh) për një objekt të thjeshtë;
- Të interpretojë shenjat dalluese të përdorura në vizatime konstruktive;
- Të interpretojë vizatime konstruktive të elementeve të ndryshme prej betoni të armuar (shtyllave, trarëve, pllakës së ndërkateve dhe rampës së shkallëve) detajet e tyre, sipas përmasave të dhëna në fletët konstruktive për një objekt të thjeshtë;
- Të përshkruajë skica e detaje të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së preventivit për elementet e ndryshme prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë radhën e punës për realizimin e skeletit për elementet konstruktive prej betoni të armuar;
- Të interpretojë tabelën e armaturës së hekurit për elemente të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar;

- Të përshkruajë mënyrën e realizimit të konstruksioneve me elementë prej betoni të armuar të parapërgatitura;
- Të interpretojë radhën e punës për realizimin e konstruksioneve prej betoni të armuar të parapërgatitura;

Punime për përgatitjen e hekurit për elementë të ndryshëm betonarme

- Të përshkruajë llojet e armaturës së hekurit në ndërtimet prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes së shufrave të hekurit sipas pozicionit për elementë konstruktivë dhe tabelës së armaturës së hekurit;
- Të listojë mjetet e punës, instrumentet matëse dhe makineritë e nevojshme për procesin e punës sipas detyrave përkatëse;
- Të përshkruajë mënyrat e matjeve dhe shënjitimit të shufrave të hekurit për elementë konstruktivë;
- Të përshkruajë teknikat e prerjes së hekurit me mjetet dhe pajisjet përkatëse;
- Të përshkruajë teknikat e kthimit të shufrave të hekurit sipas projektit të dhënë, me mjetet dhe pajisjet përkatëse;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së stafave, kavallotave, distanciatorëve;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së zgjatimeve, xhuntimeve etj.;
- Të klasifikojë shufrat e përgatitura sipas elementeve konstruktive të dhëna në tabelën e hekurave;
- Të përshkruajë teknikën dhe radhën e montimit dhe çmontimit të skelave të lëvizshme;
- Të përshkruajë mënyrën e grupimit dhe shpërndarjes së hekurit sipas elementeve konstruktivë;

Punime për vendosjen e hekurit në elementet konstruktivë

- Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me topografin për piketimin e elementeve betonarme;
- Të shpjegojë mënyrën e vendosjes së shablloneve për elementet vertikale;
- Të rendisë llojet e aksesorëve lidhës (piastra, shufra metalike, rrjeta speciale etj.) sipas përdorimit të tyre;
- Të përshkruajë teknikën e vendosjes dhe lidhjes së hekurit, distanciatorëve në mure dhe kolona, sipas të dhënave të projektit;
- Të përshkruajë teknikën e vendosjes dhe lidhjes së hekurit, distanciatorëve në trarë, dysheme e soleta ndërkatësh, sipas të dhënave të projektit.
- Të përshkruajë proceset e formimit të skeletit të armaturës së hekurit, si dhe mënyrat e lidhjes së shufrave të hekurit ndërmjet tyre (për plintat, pllakat, muret etj.) dhe me stafat (për trarët, shtyllat etj.);
- Të përshkruajë hapat për lidhjen e armaturës së hekurit të themeleve prej betoni të armuar (plinta, trarë të kryqëzuar të përmbysur dhe pllakë), si dhe montimin e tyre, sipas rastit, në kallëpet e përgatitura;
- Të përshkruajë hapat për lidhjen e shufrave të hekurit për shtyllat dhe muret, si dhe kombinimin me vendosjen e kallëpeve për to;
- Të përshkruajë hapat për lidhjen e shufrave të hekurit dhe montimin e skeletit prej hekuri në kallëpet e përgatitura për trarët e ndërkatëve dhe të shkallës;
- Të përshkruajë hapat për lidhjen e shufrave të hekurit në kallëpet e përgatitura për pllakën e ndërkatëve dhe rampën e shkallëve;

- Të përshkruajë teknikat e saldimeve që përdoren për zgjatimin e shufrave dhe lidhjen e tyre në rastet e formimit të skeletit të armaturës së hekurit;
- Të përshkruajë mënyrat e përforcimit për secilin element konstruktiv (themele, shtylla, trarë, rigela, arkitrare etj.) sipas shkallës së defektit dhe kërkesave të konstruksionit përkatës, pas përforcimit;
- Të përshkruajë mënyrat e përpunimit të hekurit në procesin e paranderjes dhe specifikat e këtij procesi;

Punime për përgatitjen dhe vendosjen e kallëpeve për elementet betonarme

- Të listojë llojet e materialeve të ndryshme për përgatitjen e kallëpeve;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes e formave të binarëve, dërrasave dhe paneleve sipas dimensioneve të elementeve betonarme;
- Të rendisë llojet e materialeve të lyerjes së sipërfaqeve të kallëpeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e lyerjes të sipërfaqeve të dërrasave dhe paneleve me materialet përkatëse;
- Të përshkruajë mënyrën e lyerjes së sipërfaqeve të dërrasave dhe paneleve me materialet përkatëse;
- Të shpjegojë teknikën e montimit të skelerisë ndihmëse dhe elementeve përforcues, si dhe të çmontimit të saj;
- Të përshkruajë teknikën e montimit të kallëpeve;
- Të përshkruajë hapat për ndërtimin e kallëpeve të themeleve prej betoni të armuar të një objekti të thjeshtë me skelet prej betoni të armuar (plinta, trarë të kryqëzuar të përmbysur dhe pllakë);
- Të përshkruajë hapat për ndërtimin e kallëpeve të shtyllave, trarëve, pllakës së ndërkatit dhe rampës së shkallëve të një objekti të thjeshtë me skelet prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë hapat për montimin dhe përforcimin e kallëpeve para procesit të betonimit;
- Të përshkruajë mënyrat e shtrëngimit të elementeve të kallëpeve;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit të vertikalishtit të kallëpeve me instrumentet përkatëse;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e fiksimit përfundimtar të kallëpeve.

Punime betonimi për elementet betonarme

- Të përshkruajë rëndësinë e organizimit, vendosjes dhe pozicionimit të makinerive të betonimit;
- Të listojë mjetet dhe makineritë e nevojshme të betonimit sipas llojit të objektit;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e larjes së kallëpeve para betonimit;
- Të përshkruajë mënyrat e përgatitjes dhe hedhjes së betonit në objekt;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së betonit të nevojshëm për procesin përkatës sipas projektit të dhënë;
- Të përshkruajë përbërësit e betoneve me receptura sipas markave, rëndësinë e respektimit të raporteve, si dhe shtesat (aditive) sipas llojit të konstruksionit prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së betonit sipas recepturës kur nevojitet;
- Të përshkruajë procesin e betonimit të elementeve sipas radhës së përcaktuar;
- Të përshkruajë procesin e vibrimit të betonit dhe rëndësinë e tij;
- Të rendisë teknikat e rrafshimit dhe nivelimit të sipërfaqes së betonit në strukturat horizontale;

- Të përshkruajë hapat e betonimit të themeleve, mureve, shtyllave, trarëve, pllakave të ndërkatëve dhe shkallëve;
- Të përshkruajë mënyrat e ndërprerjes (pozicionin e lejuar) së betonimit.

Trajtimi i elementëve betonarme pas betonimit

- Të përshkruajë trajtimin e duhur me ujë të elementeve betonarme sipas normave përkatëse;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e mbulimit të sipërfaqeve të betonit gjatë reshjeve dhe kushteve të pafavorshme atmosferike me mjetet dhe materialet përkatëse;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e dizarmimit të kallëpeve sipas radhës së përcaktuar dhe afateve;
- Të listojë llojet e defekteve kryesore gjatë betonimit;
- Të përshkruajë mënyrën e riparimit të mundshëm të sipërfaqeve të elementeve betonarme;
- Të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes së strukturave pas betonimit.

Sigurimi i cilësisë së punimeve

- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit përfundimtar të pozicioneve të hekurit, distancave ndërmjet elementeve të strukturës, përpara procesit të betonimit;
- Të përshkruajë mënyrat e verifikimit të cilësisë së punimeve të ndërtimit të kallëpeve të elementeve konstruktive prej betoni të armuar sipas specifikimeve teknike dhe skicës;
- Të përshkruajë mënyrën e kontrollit përfundimtar të përmasave të elementëve strukturorë;
- Të përshkruajë mënyrën e kontrollit përfundimtar të kallëpeve përpara procesit të betonimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e garantimit të cilësisë maksimale të lyerjes së sipërfaqeve të paneleve me lëndët përkatëse;
- Të shpjegojë mënyrat e marrjes së kubikëve të nevojshëm për testime laboratorike në mënyrë të rregullt gjatë çdo betonimi;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të afateve teknike të procesit të betonimit për garantimin e cilësisë;
- Të përshkruajë mënyrat e testimit paraprak të konsistencës së betonit;
- Të shpjegojë mënyrën e plotësimit të dokumentacionit teknik ditor dhe periodik;
- Të përshkruajë mënyrat e verifikimit të cilësisë së punimeve të lidhjes dhe montimit të armaturës së hekurit të elementeve konstruktive prej betoni të armuar sipas specifikimeve teknike dhe skicës;
- Të përshkruajë mënyrat e verifikimit të cilësisë së përgatitjes së betonit sipas recepturave dhe cilësisë së punimeve të betonimit (hedhjes në vepër të betonit) sipas specifikimeve teknike.

Sipërmarrja, edukimi i karrierës dhe ngritja e nivelit profesional

- Të shpjegojë rëndësinë e legjislacionit tatimor, kodit të punës dhe legjislacionit në fushën e lidhur me aktivitetin që kryen;
- Të shpjegojë sipërmarrjen me të gjitha elementet kryesore të saj;
- Të shpjegojë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes;
- Të përshkruajë rëndësinë e planeve ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit të punës së kryer dhe urdhrave të punës;
- Të shpjegojë regjistrimin e të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara ndaj klientëve;
- Të përshkruajë përgatitjen e raporteve periodike të punës për aktivitetet e zbatuara;
- Të shpjegojë tregun lidhur me çmimet dhe cilësinë e materialeve, pajisjeve dhe produkteve;

- Të japë shembuj të llogaritjet së kostove të materialeve dhe shërbimeve të kryera;
- Të përshkruajë përgatitjen e ofertave për punimet/shërbimet që do të kryejë;
- Të përshkruajë rëndësinë e përcaktimit të nevojave për blerjet e materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme;
- Të japë shembuj të llogaritjet së çmimit përfundimtar për punimet/shërbimet e ofruara;
- Të përshkruajë mënyrën e plotësimit të procesverbalit/dokumentit të dorëzimit të punimeve të klienti;
- Të përshkruajë teknikat e marketingut për punimet/shërbimet që do të kryejë;
- Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të vetvetes;
- Të përshkruajë metodat e zhvillimit profesional;
- Të shpjegojë rëndësinë e informimit në kohë të bashkëpunëtorëve për njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja;
- Të shpjegojë ndikimin e sipërmarrjes në biznes;
- Të shpjegojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;
- Të shpjegojë mënyrat e njehsimit të sasive metrike të punimeve të karpentierisë, hekurkthimit dhe betonimit, si dhe të zbrërthimit të materialeve përkatëse për secilin punim;
- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të përshkruajë rëndësinë e marrjes së informacionit mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të parimeve të punës në grup;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave dhe hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;
- Të përshkruajë rëndësinë e udhëzimeve nga bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës duke përdorur terminologji të qartë dhe profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të teknologjive të reja të komunikimit;
- Të shpjegojë teknikat e zgjidhjes së ankesave dhe mosmarrëveshjeve me klientët, duke përdorur komunikimin e duhur;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të parimeve të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim.

Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë rëndësinë e manualeve të përdorimit të mjeteve të punës, instrumenteve matëse dhe makinerive;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit ndërtimor në lidhje me sigurimin teknik;
- Të përshkruajë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të përshkruajë sinjalistikën (udhëzimet e shkruara) në mjediset e punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të planit të evakuimit në raste emergjence;
- Të përshkruajë planin e sigurisë dhe koordinimit të objektit;
- Të përshkruajë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullores përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
- Të përshkruajë rëndësinë e identifikimit dhe raportimit tek personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve;

- Të përshkruajë mënyrën e pastrimit dhe sistemimit të vendit të punës para, gjatë dhe pas punimeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit në mënyrë racionale të energjisë dhe materialeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e rrethimit të objektit dhe vendosjes së tabelave të sigurisë;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të protokolleve të duhura në raste pandemie;
- Të përshkruajë rregullat e ruajtjes së higjienës personale në punë dhe të kompletit të veshjeve të karpentierit, hekurkthyesit dhe betonistit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit për çdo lloj punimi të karpentierisë, hekurkthimit dhe betonimit;
- Të listojë situatat potenciale të rrezikshme, elementet që paraqesin rreziqe individuale dhe kolektive profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të procedurave të duhura për ndarjen e mbeturinave sipas llojit;
- Të përshkruajë mënyrën e ruajtjes dhe magazinimit të materialeve;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë ndarjes, grumbullimit dhe largimit të mbetjeve nga vendi i punës.

Materialet

- Të përshkruajë materialet që përdoren për shënimin dhe piketimin e elementeve të ndryshëm betonarme;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e kallëpeve të elementeve konstruktive;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e objekteve me konstruksione mbajtëse prej druri (mure, shtylla, ndërkatë e shkallë);
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e konstruksionit mbajtës të çatisë së vendit prej druri, detajeve të lidhjeve të elementeve përbërëse dhe nënshtresës;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e kapriatës së thjeshtë prej druri, detajeve të lidhjeve ndërmjet tyre dhe nënshtresës;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e lidhjes dhe montimit të armaturës së hekurit të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për përgatitjen e betonit dhe punimet e betonimit (hedhjes në vepër të betonit) të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e para betonimit të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e mirëmbajtjes së strukturave pas betonimit;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e heqjes së kallëpeve (dizarmimit) të strukturave;
- Të listojë materialet për lyerjen e kallëpeve;
- Të përshkruajë materialet për përforcimin e kallëpeve;
- Të identifikojë materialet për trajtimin pas betonimit.

Mjetet, instrumentet dhe makineritë e punës

- Të përshkruajë mjetet e punës dhe instrumentet matëse-niveluese për ndërtimin e montimin e kallëpeve të elementeve konstruktive;
- Të përshkruajë mjetet e punës dhe instrumentet matëse-niveluese për teknikat e punimeve të objekteve me konstruksione mbajtëse prej druri (mure, shtylla, ndërkatë e shkallë);

- Të përshkruajë mjetet e punës dhe instrumentet matëse-niveluese për teknikat e punimeve të lidhjes dhe montimit të armaturës së hekurit të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë mjetet dhe pajisjet e punës për prerjen dhe kthimin e hekurit;
- Të përshkruajë mjetet e punës dhe pajisjet që përdoren për përgatitjen e betonit dhe punimet e betonimit (hedhjes në objekt të betonit) të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë mjetet e punës dhe pajisjet që përdoren për punimet e para betonimit të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë mjetet e punës dhe pajisjet që përdoren për punimet e mirëmbajtjes së strukturave pas betonimit;
- Të përshkruajë mjetet e punës dhe pajisjet që përdoren për punimet e heqjes së kallëpeve (dizarmimit) të strukturave;
- Të përshkruajë llojet e makinerive që përdoren për përgatitjen e betonit dhe punimet e betonimit (hedhjes në objekt të betonit) të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë llojet e makinerive ngritëse dhe transportuese që përdoren në punimet e konstruksionit mbajtës të ndërtesës;
- Të përshkruajë mënyrën e sistemimit të materialeve, mjeteve të punës, instrumenteve matëse-niveluese dhe makinerive në vendin e punës;
- Të përshkruajë mënyrën e pastrimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës, instrumenteve matëse-niveluese dhe makinerive në vendin e punës.

Rezultatet e të nxënit në:

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin mësimor “Karpentieri, hekurkthim dhe betonim” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë aftësitë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Planifikimi dhe organizimi i punës

- Të zbatojë legjislacionin kryesor për punimet e ndërtimit;
- Të organizojë, në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Të zbatojë një projekt të dhënë;
- Të përzgjedhë mjetet dhe veglat e punës sipas proceseve të saj;
- Të organizojë vendin e punës sipas procesit të punës që do të kryejë;
- Të koordinojë punën me disiplinat e tjera për organizimin e punës;
- Të hartojë dhe zbatojë grafikun e punimeve;
- Të planifikojë materialet sipas procesit të punës;
- Të planifikojë mjetet dhe pajisjet sipas procesit të punës;
- Të planifikojë burimet njerëzore sipas procesit të punës;
- Të mirëmbajë mjetet e veglat e punës;
- Të respektojë rregullat e higjienës personale në punë;
- Të sistemojë materialet, mjetet e punës, instrumentet matëse-niveluese dhe makineritë në vendin e punës;

Konstruksione mbajtëse

- Të vizatojë shenjat dalluese të përdorura në vizatime konstruktive;
- Të vizatojë elementë konstruktive të projekt-zbatimit të një objekti të thjeshtë me skelet monolit prej betoni të armuar;
- Të lexojë fletët e vizatimeve konstruktive dhe shenjat dalluese të përdorura;
- Të përshkruajë vizatimet e elementeve konstruktive;
- Të interpretojë detaje konstruktive sipas përmasave të dhëna në fletët konstruktive për një objekt të thjeshtë prej betoni të armuar;
- Të rendisë llojet e konstruksioneve mbajtëse të ndërtesave;
- Të përshkruajë elementet konstruktive përbërëse të konstruksioneve prej betoni të armuar;
- Të interpretojë skica e detaje të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar;
- Të interpretojë mënyrën e punës së konstruksioneve prej betoni të armuar;
- Të interpretojë tabelën e armaturës së hekurit për elemente të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përzgjedhë llojet dhe mënyrën e realizimit të konstruksioneve prej betoni të armuar të parapërgatitura;

Mungon konstruksione mbajtëse

Punime për përgatitjen e hekurit për elementë të ndryshëm betonarme

- Të përzgjedhë llojet e armaturës së hekurit në ndërtimet prej betoni të armuar;
- Të përzgjedhë shufrat e hekurit sipas pozicionit;
- Të kryejë matjet dhe shënimin e shufrave të hekurit;
- Të përzgjedhë mjetet, makineritë dhe pajisjet e nevojshme për procesin e punës sipas detyrave përkatëse;
- Të kryejë prerjen e hekurit me mjetet dhe pajisjet përkatëse;
- Të kryejë kthimin e shufrave të hekurit sipas projektit të dhënë me mjetet dhe pajisjet përkatëse;
- Të përgatisë stafat, kavallotat, distanciatorët;
- Të përgatisë zgjatimet, xhuntimet etj.;
- Të grupojë shufrat e përgatitura sipas elementeve konstruktive;
- Të kryejë montimin dhe çmontimin e skelave të lëvizshme;
- Të depozitojë hekurin sipas elementëve konstruktivë;

Punime për vendosjen e hekurit në elementet konstruktivë

- Të shpërndajë materialet e përgatitura në vendin e duhur;
- Të bashkëpunojë me topografin për piketimin e elementeve betonarme;
- Të vendosë shabllonet për elementet vertikale;
- Të përzgjedhë llojet e aksesorëve lidhës (piastra, shufra metalike, rrjeta speciale etj.);
- Të vendosë hekurin, distanciatorët në mure, kolona, trarë, dysheme e soleta ndërkatësh, sipas të dhënave të projektit;
- Të formojë skeletin e armaturës së hekurit duke lidhur shufrat e hekurit ndërmjet tyre për elemente konstruktive (plinta, shtylla, trarë, pllakë ndërkatë dhe rampës së shkallëve) për një objekt të thjeshtë;
- Të kryejë montimin dhe lidhjen e hekurit të themeleve prej betoni të armuar (plinta, trarë të kryqëzuar të përmbysur dhe pllakë), sipas rastit në kallëpet e përgatitura;
- Të lidhë shufrat e hekurit për shtyllat dhe muret;
- Të lidhë shufrave e hekurit në kallëpet e përgatitura për trarët e ndërkateve dhe të shkallës;

- Të lidhë shufrat e hekurit në kallëpet e përgatitura për pllakën e ndërkateve dhe rampën e shkallëve;
- Të kryejë saldime për zgjatimin e shufrave dhe lidhjen e tyre në rastet për formimin e skeletit të armaturës së hekurit;
- Të kryejë përforcimin për secilin element konstruktiv (themele, shtylla, trarë, rigela, arkitrare etj. sipas shkallës së defektit dhe kërkesave të konstruksionit përkatës pas përforcimit;
- Të kryejë përpunimin e hekurit në procesin e paranderjes.

Punime për përgatitjen dhe vendosjen e kallëpeve për elementet betonarme

- Të përzgjedhë llojet e materialeve për kallëpe të elementeve betonarme;
- Të përgatisë format e binarëve, dërrasave dhe paneleve sipas dimensionit të elementëve betonarme;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve të lyerjes së sipërfaqeve të kallëpeve;
- Të lyejë sipërfaqet e dërrasave dhe paneleve me lëndët përkatëse;
- Të kryejë montimin e skelerisë ndihmëse dhe elementeve përforcues si dhe çmontimin e saj;
- Të kryejë montimin dhe/ose ndërtimin kallëpeve;
- Të ndërtojë kallëpet e themeleve prej betoni të armuar të një objekti të thjeshtë me skelet prej betoni të armuar (plinta, trarë të kryqëzuar të përmbysur dhe pllakë);
- Të ndërtojë kallëpet e shtyllave, trarëve, pllakës së ndërkatit dhe rampës së shkallëve të një objekti të thjeshtë me skelet prej betoni të armuar;
- Të montojë dhe përforcojë kallëpet në vepër, para procesit të betonimit;
- Të kryejë shtrëngimin e elementeve të kallëpeve;
- Të kryejë kontrollin e kallëpeve me instrumente përkatëse;
- Të kryejë fiksimin përfundimtar të kallëpeve.

Punime betonimi për elementet betonarme

- Të pozicionojë makineritë e betonimit në përputhje me kërkesat teknike të objektit;
- Të përzgjedhë makineritë e përgatitjes dhe hedhjes së betonit në vepër;
- Të llogarisë betonin e nevojshëm për betonimin përkatës;
- Të përzgjedhë përbërësit e betoneve me receptura sipas markave, duke respektuar raportet, si dhe shtesat, sipas llojit të konstruksionit prej betoni të armuar;
- Të përgatisë betonin sipas recepturës kur nevojitet;
- Të kryejë larjen e kallëpeve para betonimit;
- Të kryejë përgatitjet për hedhjen e betonit në objekt;
- Të kryejë betonimin e elementeve sipas radhës së përcaktuar;
- Të kryejë vibrimin e betonit;
- Të kryejë rrafshimin dhe nivelimin e sipërfaqes së betonit në strukturat horizontale;
- Të zbatojë hapat e betonimit të themeleve, mureve, shtyllave, trarëve, pllakave të ndërkateve dhe shkallëve;
- Të zbatojë me korrektësi mënyrat e ndërprerjes (pozicionin e lejuar) së betonit.

Trajtimi i elementëve betonarme pas betonimit

- Të kryejë trajtimin e duhur me ujë të elementeve betonarme sipas normave përkatëse;
- Të realizojë mbulimin e sipërfaqeve të betonit gjatë reshjeve dhe kushteve të pafavorshme atmosferike;

- Të realizojë dizarmimin e kallëpeve sipas radhës së përcaktuar dhe afateve;
- Të kryejë riparimet e mundshme të sipërfaqeve të elementeve betonarme;
- Të zbatojë mënyrat e mirëmbajtjes së strukturave pas betonimit.

Sigurimi i cilësisë së punimeve

- Të kryejë kontrollin përfundimtar të pozicioneve të hekurit, distancave ndërmjet elementeve të strukturës përpara procesit të betonimit;
- Të kryejë verifikimin e cilësisë së punimeve të ndërtimit të kallëpeve të elementeve konstruktive prej betoni të armuar sipas specifikimeve teknike dhe skicës;
- Të kryejë kontrollin përfundimtar të përmasave të elementëve strukturorë;
- Të kryejë kontrollin përfundimtar të kallëpeve përpara procesit të betonimit;
- Të garantojë cilësinë maksimale të lyerjes së sipërfaqeve të paneleve me lëndët përkatëse;
- Të zbatojë mënyrat e marrjes së kubikëve të nevojshëm për testime laboratorike në mënyrë të rregullt gjatë çdo betonimi;
- Të zbatojë afatet teknike të procesit të betonimit;
- Të zbatojë mënyrat e testimit paraprake të konsistencës së betonit;
- Të plotësojë në mënyrë korrekte dokumentacionin teknik ditor dhe periodik;
- Të kryejë verifikimin e cilësisë së punimeve të lidhjes dhe montimit të armaturës së hekurit të elementeve konstruktive prej betoni të armuar, sipas specifikimeve teknike dhe skicës;
- Të kryejë verifikimin e cilësisë së përgatitjes së betonit sipas recepturave dhe proceseve të betonimit (hedhjes në vepër të betonit) sipas specifikimeve teknike;
- Të kontrollojë cilësinë e punimeve të ndërtimit të kallëpeve të elementeve konstruktive prej betoni të armuar sipas specifikimeve teknike dhe skicës;
- Të kontrollojë cilësinë e punimeve të lidhjes dhe montimit të armaturës së hekurit të elementeve konstruktive prej betoni të armuar sipas specifikimeve teknike dhe skicës;
- Të kontrollojë cilësinë e punimeve të heqjes së kallëpeve sipas specifikimeve teknike.

Sipërmarrja, edukimi i karrierës dhe ngritja e nivelit profesional

- Të zbatojë legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën e lidhur me aktivitetin që kryen ;
- Të bashkëpunojë me institucionet financiare për aktivitetin e vet;
- Të përgatisë planet ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të ruajë dhe arkivojë dokumentacionin e punës së kryer dhe urdhrave të punës;
- Të regjistrojë të dhënat për faturat dhe ofertat e lëshuara ndaj klientëve;
- Të përgatisë raporte periodike të punës për aktivitetet e zbatuara;
- Të analizojë tregun lidhur me çmimet dhe cilësinë e materialeve, pajisjeve dhe produkteve;
- Të kryejë llogaritje të kostove të materialeve dhe shërbimeve të kryera;
- Të përgatisë ofertat për punimet/shërbimin që do të kryejë;
- Të kryejë blerjet e materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme;
- Të llogarisë çmimin përfundimtar për punimet/shërbimet e ofruara;
- Të plotësojë procesverbalin/dokumentin e dorëzimit të punimeve të klientit;
- Të zbatojë teknikat e marketingut për punimet/shërbimet që do të kryejë;
- Të informojë në kohë bashkëpunëtorët për njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja;
- Të kryejë trajnime profesionale;
- Të informojë në kohë bashkëpunëtorët për njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja;
- Të organizojë punën në biznes;

- Të njehsojë sasi të metrike të punimeve të karpentierisë, hekurkthimit dhe betonimit, si dhe të zbërthimit të materialeve përkatëse për secilin punim;
- Të përdorë Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të marrë informacion mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të zbatojë rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;
- Të japë/marrë udhëzime te/nga bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës duke përdorur terminologji të qartë dhe profesionale;
- Të zbatojë teknologjitë e reja të komunikimit;
- Të zgjidhë ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët, duke përdorur komunikimin e duhur;
- Të respektojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim;
- Të zbatojë rregullat për një komunikim të suksesshëm në vendin e punës (iniciativa, korrektësia, vetëkontrolli);
- Të punojë në grup/ekip duke bashkëpunuar me sektorët e tjerë;
- Të diskutojë në mënyrë profesionale me kolegët në vendin e punës;

Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të respektojë manualin e përdorimit të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive të punës;
- Të zbatojë legjisllacionin ndërtimor në lidhje me sigurimin teknik;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;
- Të zbatojë sinjalistikën (udhëzimet e shkruara) në mjediset e punës;
- Të zbatojë planin e evakuimit në raste emergjence;
- Të zbatojë planin e sigurisë dhe koordinimit të objektit;
- Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
- Të zbatojë rregulloret përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike
- Të raportojë tek personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve;
- Të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës para, gjatë dhe pas punimeve;
- Të përdorë në mënyrë racionale energjinë dhe materialet;
- Të respektojë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të respektojë protokollet e duhura në raste pandemie;
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes së higjienës personale në punë;
- Të përdorë pajisjet dhe veshjet përkatëse mbrojtëse për çdo lloj punimi të karpentierisë, hekurkthimit dhe betonimit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit për çdo lloj punimi të karpentierisë, hekurkthimit dhe betonimit.
- Të zbatojë rregulloret e sigurisë për produktet e rrezikshme dhe rekomandimet e prodhuesit për ruajtjen e materialeve;
- Të kryejë pastrimin e vendit të punës dhe sistemimin e materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të përdorura;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në rastin e punimeve me makineri elektrike;
- Të dallojë situatat potenciale të rrezikshme, elementet që paraqesin rreziqe individuale dhe kolektive profesionale;
- Të zbatojë procedurat e duhura për ndarjen e mbeturinave sipas llojit;

- Të sistemojë dhe magazinojë materialet;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë ndarjes, grumbullimit dhe largimit të mbetjeve nga vendi i punës;

Materialet

- Të përzgjedhë materialet për matjen, piketimin e elementeve të ndryshëm betonarme;
- Të përzgjedhë materialet për punimet e kallëpeve të elementeve konstruktive;
- Të përzgjedhë materialet për punimet e objekteve me konstruksione mbajtëse prej druri (mure, shtylla, ndërkate e shkallë);
- Të përzgjedhë materialet për punimet e konstruksionit mbajtës të çatisë së vendit prej druri, detajeve të lidhjeve të elementeve përbërëse dhe nënshtresës;
- Të përzgjedhë materialet për punimet e kapriatës së thjeshtë prej druri, detajeve të lidhjeve ndërmjet tyre dhe nënshtresës;
- Të përzgjedhë materialet për punimet e lidhjes dhe montimit të armaturës së hekurit të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përzgjedhë materialet për përgatitjen e betonit dhe punimet e betonimit (hedhjes në vepër të betonit) të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përzgjedhë materialet për punimet e para betonimit të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përzgjedhë materialet për punimet e mirëmbajtjes së strukturave pas betonimit;
- Të përzgjedhë materialet për punimet e heqjes së kallëpeve (dizarmimit) të strukturave.
- Të përzgjedhë materialet për lyerjen e kallëpeve;
- Të përzgjedhë materialet për përforcimin e kallëpeve;
- Të përzgjedhë materialet për trajtimin pas betonimit;

Mjetet, instrumentet dhe makineritë e punës

- Të përdorë mjetet e punës dhe instrumentet matëse-niveluese për ndërtimin e montimin e kallëpeve të elementeve konstruktive;
- Të përdorë mjetet e punës dhe instrumentet matëse-niveluese për teknikat e punimeve të objekteve me konstruksione mbajtëse prej druri (mure, shtylla, ndërkate e shkallë);
- Të përdorë mjetet e punës dhe instrumentet matëse-niveluese për teknikat e punimeve të lidhjes dhe montimit të armaturës së hekurit të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e punës për prerjen dhe kthimin e hekurit;
- Të përdorë mjetet e punës dhe pajisjet për përgatitjen e betonit dhe punimet e betonimit (hedhjes në vepër të betonit) të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përdorë mjetet e punës dhe pajisjet për punimet e para betonimit të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përdorë mjetet e punës dhe pajisjet për punimet e riparimit, mirëmbajtjes së strukturave pas betonimit;
- Të përdorë mjetet e punës dhe pajisjet për punimet e heqjes së kallëpeve (dizarmimit) të strukturave;
- Të përdorë llojet e makinerive për përgatitjen e betonit dhe punimet e betonimit (hedhjes në vepër të betonit) të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përdorë makineritë ngritëse dhe transportuese në punimet e konstruksionit mbajtës të ndërtesës;

- Të sistemojë materialet, mjetet e punës, instrumentet matëse-niveluese dhe makineritë në vendin e punës.
- Të mirëmbajë materialet, mjetet e punës, instrumentet matëse-niveluese dhe makineritë në vendin e punës;

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.